



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI BUJQËSOR I TIRANËS
DREJTORIA E EKONOMISË DHE FINANCËS**

Nr. ____ Prot

Tiranë, më ____ . ____ . 2022

**Lënda: Përshkrim të tarifave të shkollimit dhe të vendimeve të marra për vitin akademik
2021 – 2022 :**

1. Tarifat e shkollimit për ciklin e parë, ciklin e dytë dhe programet e integruara të studimeve, për të gjitha programet e studimit, si dhe programet e studimeve profesionale me kohë të plotë, për vitin akademik 2021 – 2022, janë miratuar sipas Vendimit të Bordit të Administrimit Nr.51, datë 13.08.2021, me nr. 1435/1 Prot.
2. Studenti i është nënshtruar vetëm një tarife vjetore shkollimi.
3. Pagesa e tarifës vjetore të shkollimit për vitin akademik 2021 – 2022 do të bëhet me dy këste. Kësti i parë do të paguhet deri më datë 25 Janar 2022 sipas Vendimit të Rektoratit Nr.2, datë 07.01.2022 me nr. 17 Prot.
4. Të gjithë studentët që studiojnë në programet e ciklit të parë të studimeve, Bachelor, DIND, si dhe programet e studimeve profesionale me kohë të plotë, të cilët në vitin akademik 2021 – 2022 janë **viti i parë i rregullt**, paguajnë 50% të tarifës së shkollimit sipas VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018.
5. Të gjithë studentët që studiojnë në programet të ciklit të parë të studimeve, Bachelor, DIND, si dhe programet e studimeve profesionale me kohë të plotë, **të vitit të dytë dhe më pas**, të cilët kanë pasur notë mesatare 6 (gjashtë) e lartë të vitit paraardhës, përfitojnë të drejtën e përgjysmimit të tarifës së shkollimit sipas VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018.
6. Të gjithë studentët, që studiojnë në programet e ciklit të parë të studimeve, Bachelor, DIND, si dhe programet e studimeve profesionale me kohë të plotë, të vitit të dytë dhe më pas, të cilët kanë notë mesatare nën 6 (gjashtë) në përfundim të vitit akademik, paguajnë tarifën e plotë të shkollimit për vitin akademik 2021 – 2022 sipas VKM nr. 778, datë 26.12.2018 dhe gjithashtu sipas Vendimit të Bordit të Administrimit Nr.51, datë 13.08.2021, me nr. 1435/1 Prot.
7. Sipas Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 51, datë 13.08.2021 me nr. 1435/1 Prot., janë miratuar tarifat e shkollimit me kredite për vitin akademik 2021 – 2022, për studentët :

- a. Studentët e vitit të **dytë të studimeve profesionale** (programet 2-vjecare), të cilësuar në bazë të rregullores së studimeve si përsëritës, të cilët për vitin akademik 2021 – 2022 nuk kanë asnjë lëndë për frekuentim dhe kanë më pak se 30 kredite të pashlyera, të paguajnë tarifën për kreditet e mbetura.
 - b. Studentët e **vitit të tretë të studimeve Bachelor**, të cilësuar në bazë të rregullores së studimeve si përsëritës, të cilët për vitin akademik 2021 – 2022 nuk kanë asnjë lëndë për frekuentim dhe kanë më pak se 30 kredite të pashlyera, të paguajnë tarifën për kreditet e mbetura.
 - c. Studentët e **vitit të pestë të studimeve DIND**, të cilësuar në bazë të rregullores së studimeve si përsëritës, të cilët për vitin akademik 2021 – 2022 nuk kanë asnjë lëndë për frekuentim dhe kanë më pak se 30 kredite të pashlyera, të paguajnë tarifën për kreditet e mbetura.
8. Sipas Vendimit të Bordit të Administrimit nr. 51, datë 13.08.2021 me nr. 1435/1 Prot., janë miratuar tarifat e shkollimit me kredite për vitin akademik 2021 – 2022, për studentët :
- a. Studentët që studiojnë në ciklin e dytë të studimeve (**Master Shkencor dhe Master Profesional**) pas përfundimit të kohëzgjatjes normale të programit të studimit, që nuk kanë shlyer të gjitha provimet e parashikuara për programin e studimit deri në përfundim të vitit akademik, konsiderohen studentë mbetës / përsëritës.
 - b. Për lëndët përsëritëse, studentët e vitit të parë dhe të dytë përsëritës, të ciklit të dytë të studimeve (Master Shkencor dhe Master Profesional), të paguajnë cdo vit akademik tarifën për kreditet e mbetura të miratuara në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 51, datë 13.08.2021 me nr. 1435/1 Prot..